



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE
SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Histori bërthamë

Varianti B

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	D	A	D	C	B	D	A	B	D	C

• *Pyetjet me zhvillim*

Pyetja 11

Model përgjigjeje

a) *Objektivi që u arrit:*

- çlirimi i vendit
- Ruajtja e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar

1 pikë Nëse shkruan një nga objektivat që u arritën

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

b) *Objektivat që nuk u arritën*

- Vendosja e një regjimi demokratik në Shqipëri
- Bashkimi i të gjitha territoreve shqiptare

2 pikë nëse shkruan dy objektivat që nuk u arritën

OSE

1 pikë nëse shkruan një nga objektivat që nuk u arritën

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 12**Model përgjigjeje**

- a) *Vendet që e njohën:* Bashkimi Sovjetik dhe vendet e bllokut komunist si edhe Franca
Vendet që nuk e njohën: SHBA, Angli etj.

2 pikë Nëse shkruan një nga shtetet që e njohën dhe një nga shtetet që nuk e njohën qeverinë shqiptare

OSE

1 pikë Nëse shkruan një nga shtetet që e njohën **OSE** një nga shtetet që nuk e njohën qeverinë shqiptare

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

- b) Për shkak të mungesës së demokracisë gjatë zgjedhjeve.

Incidenti i kanalit të korfuzit

1 pikë nëse shkruan një nga shkaqet e acarimit të marrëdhënieve

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 13**Model përgjigjeje**

- a) Aplikimi i ekonomisë së komanduar (centralizuar), nëpërmjet krijimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe kolektivizimit të bujqësisë
 b) Mbështetja në forcat e veta
 c) Ndalimin e investimeve të huaja në vend etj

3 pikë nëse analizon tre nga shkaqet e krizës ekonomike.

OSE

2 pikë nëse analizon dy nga shkaqet e krizës ekonomike.

1 pikë nëse analizon një nga shkaqet e krizës ekonomike.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 14**Model përgjigjeje**

- a) Monteskjë argumentonte ndarjen e pushteteve në tri hallka: Hallka ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore. Sipas Monteskje pushtetet nuk duhet të jenë kurrsesi në duart e një personi të vetëm.
 b) Ai argumentonte se kjo lloj ndarjeje shërbente si garanci për të mos kaluar në absolutizëm.

3 pikë nëse bën ndarjen e saktë të tre pushteteve dhe përcakton rëndësinë e kësaj ndarjeje.

OSE

2 pikë nëse bën ndarjen e saktë të tre pushteteve

1 pikë nëse përcakton një ose dy prej pushteteve

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Shënim: nëse nxënësi bën vetëm rëndësinë e ndarjes së pushteteve ai nuk do të marrë asnjë pikë

Pyetja 15**Model përgjigjeje**

- a) Mbiprodhimi i mallrave;
 b) Mbyllja e bankave dhe fabrikave;
 c) Papunësia;
 d) Keqësimi i treguesve socialë të qytetërimit;
 e) Pesimizmi dhe frika për të ardhmen.

3 pikë nëse shkruan tre nga treguesit e krizës ekonomike

OSE

2 pikë nëse shkruan dy nga treguesit e krizës ekonomike

1 pikë nëse shkruan një nga treguesit e krizës ekonomike

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 16

Model përgjigjeje

- Bizant – perandoria Romake e Lindjes me qendër Kostandinopojën
- Metropol i Ilirikut – qyteti i Durrësit për rëndësinë e tij dhe rolin e madh që luante si një port i rëndësishëm edhe për Bizantin
- Asimilim – procesi i zhdukjes së vlerave etno-kulturore të një populli nga një popullsi tjetër

3 pikë nëse jep një shpjegim të saktë të tre koncepteve

OSE

2 pikë nëse jep një shpjegim të saktë të dy koncepteve

1 pikë nëse jep një shpjegim të saktë të një prej koncepteve

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 17

Model përgjigjeje

- Luftuan për të krijuar epërsi në garën e armatimeve, të bazuara në armët bërthamore. Kështu në gusht të vitit 1949 BS prodhoi bombën atomike e më pas atë me hidrogjen, gjë që i dha fund monopolit amerikan atomik
- Krijimi i blloqeve ushtarake si NATO dhe Traktati i Varshavës. Në prill të vitit 1949 u krijua Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Aleanca u zotua për t'i dhënë ndihmë çdo shteti anëtar, në rast se ndaj tij do të merrej ndonjë agresion i armatosur. Ndërkaq BS iu përgjigj me krijimin e aleancës ushtarake të Traktatit të Varshavës në vitin 1955, shtete anëtare të së cilës ishin vendet e bllokut komunist.
- Ndërtimi i Murit të Berlinit në vitin 1961, i cili vërtetoi në mënyrë simbolike thënien e Çërçillit për “perden e hekurt”

3 pikë nëse jep një analizë të plotë të tre drejtimeve ku u përqendrua Lufta e Ftohtë

OSE

2 pikë nëse jep një analizë të plotë të dy drejtimeve ku u përqendrua Lufta e Ftohtë

1 pikë nëse jep një analizë të plotë të një prej drejtimeve ku përqendrua Lufta e Ftohtë

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 18

Model përgjigjeje

- Sigurimin e pavarësisë së Shqipërisë
- Formimin e shtetit kombëtar shqiptar
- Ruajtjen e tërësisë territoriale shqiptare
- Shkolla dhe gjuhë shqipe në administratë
- Reforma të thella ekonomike për zhvillimin e vendit

3 pikë nëse shkruan tre nga pikat e programit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare

OSE

2 pikë nëse shkruan dy nga pikat e programit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare

1 pikë nëse shkruan një nga pikat e programit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 19**Model përgjigjeje**

Zogu fitonte një pushtet të fortë pasi, sipas Statutit Themeltar të Republikës së Shqipërisë të vitit 1925, presidenti kishte këto kompetenca:

- a) Presidenti do të ishte njëkohësisht edhe kryetar i qeverisë
- b) Presidenti kishte të drejtën e vetos pa apel
- c) Presidenti kishte të drejtën e shpalljes së zgjedhjeve të reja në vend

Republika mori kështu formën e një republike presidenciale

3 pikë nëse shkruan tre nga kompetencat e presidentit sipas Statutit.

OSE

2 pikë nëse shkruan dy nga kompetencat e presidentit sipas Statutit

1 pikë nëse shkruan një nga kompetencat e presidentit sipas Statutit

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 20**Model përgjigjeje**

E veçanta

- Sipas Statutit Organik kryetari më i lartë i administratës civile e ushtarake ishte princ Vidi, ndërsa Statuti i Lushnjes krijoi Këshillin e Lartë prej 4 vetash në formë regjence si kreu më i lartë i shtetit, i përbërë nga përfaqësues të 4 komuniteteve fetare
- Sipas Statutit Organik organi legjislativ ishte Asambleja Kombëtare, ndërsa ndërsa Statuti i Lushnjes krijoi Këshillin Kombëtar të quajtur Senat me funksione legjislative

Të përbashkëtat

- Nuk përcaktuan fe zyrtare
- Garantuan të drejtën e pronës

3 pikë nëse shkruan një të veçantë dhe dy të përbashkëta.

OSE

2 pikë nëse shkruan një të veçantë dhe një të përbashkët **OSE** dy të përbashkëtat

1 pikë nëse shkruan një të veçantë **OSE** një të përbashkët

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare